



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



---

## EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 08.02.2021,  
duke filluar në orën 13:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Egzon Azemi, Fadil Gashi, Vala Peshku, Sami Boroci dhe Genc Sherifi.

**Mungoi:** Blerand Stavileci.

Të pranishëm ishin edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Adonis Tahiri, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore dhe Leonora Shabani - Bajraktari, anëtare e Kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, Agim Gashi propozoi që pika e 15-të e rendit të ditës të qitet si pikë e pestë e rendit të ditës, ndërsa të tjerat të mbesin kështu siç janë, sepse shpesh po ndodh që në fund të seancës të mos ketë kuorum. NPL-të nuk është mirë të mbesin pa aksionarë.

**Halim Halimi** propozoi që kjo pikë të jetë para raportit financiar.

**Kryesuesi** sqaroi se pika e 15-të është për kompensim, jo për caktimin e anëtarëve në komisionet aksionarëve në NPL-ve.

**Agim Gashi** propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës "**Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01-020/04-152233/18, të dt.18.01.2018, për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës**".

**Kryesuesi** kërkoi që të mos zgjaten shumë, se te raportet e kemi raportin 3-mujor financiar dhe raportin vjetor, që mund t'i përfshijmë në një pikë dhe në fund raportet e ndërmarrjeve.

**Agim Gashi** propozoi që kushdo nga asamblistët që e lëshon seancën pa arsye, t'i hiqet mëditja.

**Kryesuesi** tha se edhe për punë të Kuvendit kur ka propozime të rëndësishme, e lexova në Rregullore, pika e 10-të e nenit 3, thotë se as në diskutim nuk shtrohet nëse nuk i plotëson kriteret të cilat i parasheh Rregullorja, me qenë urgjente dhe e rëndësisë publike pika e rendit të ditës. Ne

mund të kemi tolerancë nëse kemi ndonjë gjë të rëndësisë së veçantë, por jo me hapur diskutimin, secili me diskutuar për të njëjtën pikë, propozon dikush, shefat e grupeve parlamentare japin mendimin e GP-ve, e kryejmë dhe vazhdojmë më tutje.

**Egzon Azemi** u shpreh se sipas Rregullores, SHGP-të mund të diskutojnë derisa të vendoset për futjen ose jo si pikë e rendit të ditës, pasi të futet në rendin e ditës, kanë qasje edhe të tjerët.

**Halim Halimi** theksoi se shpesh po ndodhë që të futen pika të rendit të ditës aty për aty, kështu që mos të lejojmë nëse nuk kalon në Komitet. Përjashtim kanë pikat që janë me urgjencë, por nëse nuk janë urgjente mos me i futur.

**Egzon Azemi** pyeti se a e kemi të seancës së fundit, të datës 10, pikën e fundit që mbeti pa u përfunduar në mungesë të kuorumit.

**Kryesuesi** tha jo, sepse kërkuat me e tërhequr, nëse doni e fusim si pikë të rendit të ditës për seancë.

**Egzon Azemi** theksoi se do të duhej të ishte **“Propozimvendimi për ndalimin e ndërtimeve në gjithë zonën e Peizazhit të mbrojtur të Gërmisë, deri në miratimin e Planit menaxhues të parkut”**.

**Adonis Tahiri** propozoi një pikë për futje në rendin e ditës lidhur me kërkesën e përbashkët të UP-së, Qendrës së Studentëve dhe Institutit të Historisë, Institutit Albanologjikë, Shoqatës së të Burgosurve, janë 8 organizata që kanë bërë kërkesën, sepse më 11 mars të këtij viti është 40-vjetori i protestave të vitit 1981, që të vendoset një pllakë përkujtimore për shënimin e kësaj dite. Ideja e tyre që ka ardhur si kërkesë, është për lokacionin në oborrin e Mensës së Studentëve, kishte qenë mirë me u futur në rend dite për **Kuvend “Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore me rastin e përvjetorit të demonstratave të 11 marsit të vitit 1981”**.

**Agim Gashi** pyeti se a është fjala për caktim të lokacionit, dhe për mbledhje të Kuvendit le të na dërgohet propozimvendimi dhe skica për vendin e vendosjes së pllakës.

**Adonis Tahiri** sqaroi, duke thënë se do të vendoset te këndi te Mensa e Studentëve.

**Halim Halimi** u shpreh i pajtimit me mendimin e drejtorit, por kërkoi që për mbledhje të Kuvendit të dërgohet materiali lidhur me këtë çështje.

**Egzon Azemi** pyeti se çka kishim mundur me bërë ne si GP i secilës parti, së paku një diskutim, çka kishim mundur me bërë për nder të ditëlindjes së Adem Demaçit, meqenëse si Komunë ende nuk kemi bërë ndonjë emërtim të ndonjë objekti kulturor, shkolle, rruge etj. Do të duhej menduar të gjitha subjektet për ndonjë propozim. Samiu po propozon ndonjë biblioteke ose diku tjetër, që kishim mundur me propozuar në seancën e radhës ose me u mbajtur një seancë solemne me rastin e ditëlindjes.

**Kryesuesi** dha sqarime, duke cekur se e kanë formuar një grup punues, pasi po ka propozime të vazhdueshme. Kemi pasur takim dhe kemi kërkuar që me i pasur propozimet e secilit dhe me i sjellë për diskutim këtu. Ekziston një listë e komisionit që ka qenë më herët, mirëpo ne duhet ta bëjmë një listë tjetër me propozime për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, dhe me ia bashkëngjitur listës së mëhershme që është miratuar në Kuvend.

**Sami Boroci** pyeti se a është formuar ai grup punues me anëtarë të Kuvendit.

**Kryesuesi** pohoi se me anëtarë të Kuvendit është formuar grupi punues.

**Halim Halimi** cekur se ai ka qenë një komision për emërtimin e rrugëve dhe shesheve.

**Kryesuesi** theksoi se ai ka qenë një komision, por ne si Kuvend e kemi formuar një si grup punues.

**Sami Boroci** bëri të ditur se qe katër vjet kemi pasur kërkesa të reja për këtë çështje, kështu që kisha lënë një derë hapur që me bërë zgjidhje së pari këtu, kështu është një lloj riemërtimi skandaloz i shumë rrugëve. Kemi marrë ankesa jashtëzakonisht të shumta për shumë rrugë të Prishtinës.

**Agim Gashi** kërkoi që në rast se diskutohet kjo temë sot, me bërë përpjekje që mos me pasur kompetenca të ndryshimeve të rrugëve, se ka me pasur kërkesa të shumta prej lagjeve që me iu ndryshuar emrat rrugëve, të diskutojmë si Kuvend dhe të përgatisim grupin punues që të kryejë punë.

**Egzon Azemi** shprehu mendimin se me këtë nuk do të duhej të merrej Kuvendi, në këtë rast të emrave të rrallë, siç është Adem Demaçi. Ky rast besoj se do të duhej diskutuar në Kuvend.

**Adonis Tahiri** dha sqarime, duke cekur se me sa e di unë, për së gjalli iu ka vendosur emri sheshi "Adem Demaçi", te Rrethi. Sipas informatave që kemi, nuk mundet sheshi dhe rruga me qenë me të njëjtin emër, por mundemi ndonjë objekti si bibliotekës e diçka tjetër.

**Vala Peshku** u shpreh se nëse dëshirojmë të hapim temën e emërtimeve dhe komisioneve, duhet shtua edhe një element, që unë kam me e shty në Kuvendin e Komunës, që emërtimi i rrugëve me u bërë në baza gjinore, 50 me 50. Ky komision as në të kaluarën, por as tani nuk ka punuar fare.

**Sami Boroci** nuk u shpreh i pajtimit që me i riemërtuar të gjitha rrugët, por vetëm për rrugët që ka ankesa.

**Vala Peshku** sqaroi, duke thënë se nuk po kërkoj ndërrimin e emërtimeve të rrugëve, por po them aty me qenë një standard, edhe me qenë mënyrë kornizë ligjore, e cila ka me detyruar secilin Kuvend të ardhshëm me respektuar aspektin gjinor, e me ditur se nuk mundën vetëm me emëruar emra të djemve dhe burrave, por me qenë 50 me 50.

**Leonora Shabani - Bajraktari** dha sqarime, duke bërë të ditur se më 8 mars 2018, Kuvendi i Komunës ka votuar rekomandime, ku kemi ofruar edhe propozimet për emërtimin e rrugëve sa i përket gjinisë femërore.

**Halim Halimi** theksoi se në komision për emërtimin e rrugëve dhe shesheve ka pasur mjaft femra. Në komision është dashur me ngritur zërin, se ne të gjithë jemi që me emërtuar sa më shumë rrugë me emra të gjinisë femërore.

**Vala Peshku** theksoi se unë jam duke folur për tani, jo për mandatin e kaluar.

Sa i përket pikave të rendit të ditës, mendoj se janë shumë pika. Unë kam një propozim. Meqenëse pas dite nuk po qëndrojnë të gjithë në sallë, unë propozoj që në fillim, paradite me filluar me të gjitha pikat tjera, me i shtyrë përpara vetëm këto katër pikat, raportet financiar edhe raportet e ndërmarrjeve me i lënë për pas dite, vetëm renditjen me ia ndryshuar.

**Kryesuesi** tha se në këtë rend të ditës janë katër pika, për të cilat do të ketë diskutim më tepër. Njërin nga pikat mund ta bëjmë bashkë, raportin tremujor dhe raportin vjetor, e diskutojmë bashkë

e i votojmë veç e veç, pastaj raportet e ndërmarrjeve, d.m.th. tri pika janë që kanë me u diskutuar, të tjerat më shumë janë votim, andaj mendoj se nuk ka me zgatur shumë takimi.

**Agim Gashi** tha se ne jemi përfaqësues të GP-ve dhe në qoftë se ne këtu dakortohemi me shkuar këto pika të rendit të ditës, nuk po kuptoj se pse po lindin ide në Kuvend dhe po diskutojmë 1-2 orë për të njëjtin problem, në parim atë që kalojmë këtu, bëni përpjekje me menaxhuar atje, nëse kemi një marrëveshje të tillë nuk do të humbim nga 1-2 orë në Kuvend.

**Sami Boroci** u deklarua se për tema të reja në Kuvend aty për aty, nuk do t'i votoj më kurrë pa menduar, analizuar të paktën seancën tjetër.

**Vala Peshku** theksoi që të dërgohen më herët propozimet, i diskutojmë dhe prej KPF- së e dërgojmë në Kuvend dhe aty shqyrtohen pikat.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua ky**

#### REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për donacion të automjeteve të vjetra të Komunës së Prishtinës për nevojat e Qendrës së Trajnimit të FSK-së;
3. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2020 (TM4);
4. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2020;
5. Propozimvendimi për miratimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021;
6. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01.463/01-139108/20, të dt. 12.08.2020, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Ismail Shillova, Faik Breznica dhe Osman Breznica;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Besnik Lecit;
8. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaqit dhe Sevdail (Bajram) Dakut;
9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Arbër (Ejup) Nezirit, Fatos Nezirit dhe Flamur (Ymer) Nezirit;

10. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Arben Hasanit;
11. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bejtush Gashit;
12. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01.463/01-33129/20, të dt. 10.02.2020, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Xhavit (Isa) Vllasaliut;
13. Diskutim lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Kuzhina Qendrore", SHA, Prishtinë;
14. Diskutim lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Trafiku Urban", SHA, Prishtinë;
15. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01-030/01-0210515/20, dt. 13.11.2020, për caktimin e kompensimit për anëtarët e komisioneve të aksionarëve të NPL-ve;
16. Të ndryshme.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

#### Pika e dytë

Propozimvendimi për donacion të automjeteve të vjetra të Komunës së Prishtinës për nevojat e Qendrës së Trajnimit të FSK-së.

Kryesuesi dha sqarime lidhur me këtë pikë, duke cekur se nënkryetari, z. Muhedin Nushi, ka pasur një kërkesë nga FSK-ja, që veturat të cilat realisht nuk mund të shiten, të cilat janë të papërdorshme, ata i kanë kërkuar për ushtrime. Është plotësim-ndryshim i vendimit që është miratuar më herët për t'i shitur veturat, d.m.th. ato nuk shiten, por një pjesë jepet donacion.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për donacion të automjeteve të vjetra të Komunës së Prishtinës për nevojat e Qendrës së Trajnimit të FSK-së dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### Pika e tretë

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2020 (TM4).

#### **Pika e katërt**

##### **Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2020.**

**Agim Gashi** tha se vërejtjet e dhëna sigurisht se janë në të mirë të raportit. Te pjesa e të hyrave vërehen rënie në çdo njësi buxhetore në Kosovë, edhe te ne afër 5 milionë, por tani na pasqyrohet vlera e planifikuar 119 milionë, bashkë me bartje, që është reale për planifikimin, por kur bëjmë krahasimin te shpenzimet me gjendjen e realizuar, ne nuk mund ta marrim 119 milionë si gjendje e realizuar, sepse mungojnë 5 milionë nga të hyrat vetanake, dhe është bërë njëfarë prerje aty planifikimi – realizimi i të hyrave dhe pastaj realizimi i shpenzimeve.

**Valbona Ahmeti - Makolli** theksoi se me kërkesën e juaj, të KPF-së dhe Kuvendit, i kam paraqitur të gjitha sipas kërkesës.

**Agim Gashi** tha se te pjesa përshkruese, mendova se 99 % e njerëzve e lexojnë atë pjesën përshkruese, aty është mirë me një fjali me sqaruar problemin.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2020 (TM4) dhe Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2020, dhe dërgohen në Kuvend për miratim.

#### **Pika e pestë**

##### **Propozimvendimi për miratimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021.**

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### **Pika e gjashtë**

Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01.463/01-139108/20, të dt. 12.08.2020, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Ismail Shillova, Faik Breznica dhe Osman Breznica.

Osman Bllaca bëri të ditur se vetëm një numër ndryshon në këtë propozimvendim.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01.463/01-139108/20, të dt. 12.08.2020, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Ismail Shillova, Faik Breznica dhe Osman Breznica dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### **Pika e shtatë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Besnik Lecit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Besnik Lecit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e tetë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaqit dhe Sevdail (Bajram) Dakut.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Gëzim (Sabri) Thaqit dhe Sevdail (Bajram) Dakut dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e nëntë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Arbër (Ejup) Nezirit, Fatos Nezirit dhe Flamur (Ymer) Nezirit;

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Arbër (Ejup) Nezirit, Fatos Nezirit dhe Flamur (Ymer) Nezirit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e dhjetë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Arben Hasanit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Arben Hasanit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e njëmbëdhjetë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bejtush Gashit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Bejtush Gashit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e dymbëdhjetë**

Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr.01.463/01-33129/20, dt. 10.02.2020, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Xhavit (Isa) Vllasaliut.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01.463/01-33129/20, dt. 10.02.2020, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Xhavit (Isa) Vilasaliut dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e trembëdhjetë**

Diskutim lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Kuzhina Qendrore", SHA, Prishtinë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua diskutimi lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Kuzhina Qendrore", SHA, Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e katërbëdhjetë**

Diskutim lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Trafiku Urban", SHA, Prishtinë.

Kryesuesi shprehu mendimin se duhet të quhet informatë e jo raport.

Leonora Shabani – Bajraktari pyeti se a mundet drejtori me marrë pjesë.

Agim Gashi tha se mundet me marrë pjesë drejtori, por me kërkesën tonë.

Sami Boroci theksoi se për çështje teknike specifike, ne kemi kërkuar herën e kaluar me qenë i pranishëm edhe menaxhmenti.

Fadil Gashi tha se obligative e ka aksionari, drejtori nuk e ka obligim, mundet mos me ardhur.

Vala Peshku bëri të ditur se në seancën e kaluar e ka paraqitur një pyetje për ndërmarrjen "Termokos", e përgjigja më ka ardhur tek parmbremë dhe përgjigje e mangët, nuk kam informatë të saktë.

Fadil Gashi u shpreh se aksionari është menaxhmenti kryesori në ndërmarrje me bord.

Vala Peshku u shpreh e pajtimit me mendimin e Fadilit, se aksionari është në krye dhe duhet me ditur secilën gjë se çka po ndodhë dhe duhet pasur njohuri në financa, në industrinë në të cilën është.

Sami Boroci tha se aksionarët as nuk e kanë idenë se çka po ndodhë në ndërmarrje.

Agim Gashi u shpreh se aksionari është pronari, dhe pronari duhet ditur të gjitha gjërat, sepse aksionari e përfaqëson pronarin - Komunën.

Kryesuesi konstatoi se u miratua diskutim lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Trafiku Urban", SHA, Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend.

**Pika e pesëmbëdhjetë**

Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimi, nr. 01-030/01-0210515/20, dt. 13.11.2020, për caktimin e kompensimit për anëtarët e komisioneve të aksionarëve të NPL-ve.



**Sami Boroci** pyeti se a është për ta lënë në kompetencë të tyre, të ndërmarrjeve publike, sipas kësaj a i bie se janë të obliguara ndërmarrjet publike, apo i bie që mbeten në vullnetin e tyre.

**Kryesuesi** bëri të ditur se me këtë obligohen prej Kuvendit.

**Sami Boroci** kërkoi sqarime nga Zyra ligjore, se a zbatohet tani ky Vendim në baza ligjore.

**Fatos Dibra** dha sqarime, duke thënë se Ligji nuk e përcakton a paguhen apo nuk paguhen aksionarët, por ky Vendim i Kuvendit komunal është obligues për ndërmarrjet dhe ndërmarrjet jonë të obliguara me zbatuar, nuk është që Ligji e ndalon, kështu që nuk ka shkelje ligjore dhe NP-të duhet zbatuar.

**Fadil Gashi** pyeti se a ka ndonjë shifër deri në sa mundet me shkuar ndërmarrja.

**Sami Boroci** dha sqarime, duke thënë se në vendimin e kaluar ka qenë paga minimale për të gjithë.

**Agim Gashi** sqaroi se në vendimin e kaluar jemi bazuar në pagën minimale të ndërmarrjes, ka qenë 300 €. Unë pata reaguar se ndërmarrja "Sport Marketing" i merr 200€, ndërsa "Ndërmarrja Publike Banesore" i merr 500€, e kjo i bie se disa ndërmarrje aksionare paguhen sa dyfishi i pagës së këshilltarëve! Kjo është një padrejtësi e madhe, do të duhej caktuar një vlerë për të gjithë njëjtë.

**Fadil Gashi** pyeti z. Agimin se a kemi të drejtë ne me e caktuar vlerën.

**Agim Gashi** theksoi se ka komuna që kanë aplikuar para nesh, si Gjilani etj. dhe jam interesuar për këtë, më kanë thënë po dhe i paguan ndërmarrja, po ashtu kam pyetur për procedurat e caktimit të vlerës.

**Fadil Gashi** pyeti se a mundemi ne SHGP me u marrë me këtë çështje dhe me u dakortuar për caktimin e vlerës.

**Agim Gashi** tha se si e kanë zgjidhur vlerën këto komuna, po të kishte shkelje në procedura për pagesë, do të reagonte niveli qendror.

**Fatos Dibra** bëri të ditur se nuk ka shkelje të procedurave.

**Vala Peshku** tha se nuk duhet nisur në diskutim me pagën minimale, por pajtohem përgjithësisht me një rrogë minimale të ndërmarrjes që qëndron, se ka ndërmarrje që qëndron shumë mirë dhe tjetër që qëndron shumë keq dhe nganjëherë jemi duke bërë diskriminim.

**Sami Boroci** u shpreh i pajtohem me znj. Peshku, por edhe rëndësia e ndërmarrjeve te një është shumë më e madhe dhe ka shumë më shumë punë sesa te një tjetër, qysh është rëndësia e Kuvendit të Prishtinës shumë më e madhe se rëndësia e Kuvendit të ndonjë komune tjetër dhe kjo mundet me u marrë.

**Vala Peshku** tha se të gjithë paguhen njësoj.

**Agim Gashi** si shembull përmendi Parteshin, i cili ka 3 mijë banorë, kurse Prishtina 200 mijë banorë, dhe kryetarët paguhen njëjtë.

**Sami Boroci** tha se nuk paguhen njëjtë, se kryetari i Prishtinës me Ligjin për Prishtinën paguhet më shumë, por vetëm kryetari.

**Vala Peshku** tha se problemin e ka tek parimi.

**Kryesuesi** pyeti se a jeni në parim që me pagën minimale që është në Kosovë.

**Sami Boroci** pyeti se pagesa e anëtarëve të Bordit a është e njëjtë në të gjitha ndërmarrjet apo dallon.

**Fadil Gashi** u përgjigj, duke thënë se pagesa e anëtarëve të Bordit është e njëjtë për të gjitha ndërmarrjet.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr.01-030/01-0210515/20, dt. 13.11.2020, për caktimin e kompensimit për anëtarët e komisioneve të aksionarëve të NPL-ve dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Të ndryshme

Leonora Shabani - Bajraktari tha se kemi shumë pika të rendit të ditës për këtë seancë, sepse është dashtë me marrë edhe raportimin e Komitetit me aftësi të kufizuara, me shikuar se çka po veprojnë, a po e ngrenë zërin me u aktivizuar, me u fuqizuar ai grup, me ngre zërin më shumë.

*Mbledhja përfundoi në orën 13:45.*

Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit  
Agim Kuleta

